Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**25.08.2023**	**11.09.2023**	**2023/0610**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.08.2023, OE "PROGLOBAL SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0610, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "PROGLOBAL SH.P.K."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pajisje personale mbrojtese ne pune (aksesor)" me nr. të prokurimit: "KEK-23-2997-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a..Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0610 i dt:23.08.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit

Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 70 - Standardet për Sigurimin e Cilësisë

Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Te nderuar,

Operatori Ekonomik "Proglobal"shpk, bazuar ne dispozitat e nenit 108/A, te LPP-se, me datën 07.08.2023, ka parashtruar kërkese për ri shqyrtim te vendimit dhe e ka kundërshtuar arsyetimin eliminimit te ofertes.

Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës, me datën 15.08.2023, nxjerr vendim dhe refuzon kërkesën tone si te pa bazuar me arsyetimin se ne disa nga produktet nuk janë prezantuar sipas specifikave teknike.

Pretendimi Ankimor 1.

Autoriteti kontraktues – KEK sha, vendimin e datës 15.08.2023, fillimisht e ka nxjerre jashtë afatit ligjor te përcaktuar me paragrafin 6, te nenit 108/A, te LPP-se, ku përcaktohet:

- "Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni.

Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë".

OE ankues, kërkesën për ri shqyrtim e ka parashtruar me datën 07.08.2023, përderisa AK, vendimin dhe refuzimin e ka nxjerr me datën 15.08.2023, pra jashtë afatit te paraparë me ligj.

Po ashtu AK, sipas vendimit kundrejt kërkesës për ri shqyrtim, nuk i ka trajtuar pretendimet tona ankimore, siç përcaktohet me paragrafin 8 nënparagrafi 8.4, te nenit 108/A, te LPP-se ku përcaktohen rastet kur AK mund ta refuzoj kërkesën si te pa bazuar: "autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi".

Pra AK – KEK sha, nuk i ka trajtuar faktet dhe pretendimet tona cfare ne kemi kërkuar.

Arsyetimi i AK-se, për eliminim te ofertës sonë dhe i pa trajtuar me vendim lidhur me Dorëza gome mbrojtëse nga kimikatet – , me aresyetim, Materiali i dorezave eshte ofruar coton lingin ndersa eshte kerkuar nitril. Eshte ofruar gjatesia 35cm, NUK QENDRON.

Ne DT pozicion 1 eshtë kerku, dorezat te jene nga Materiali nitril, pjesa e brendshme nga pambuku, me Standardin EN374-2; EN 420; EN388;

Materiali i dorezave te ofruara PVC7335 eshtë nga PVC (Polyvinyl Chloride) dhe cotton,

Apo variant i asaj cfare eshte përcaktuar ne dosje te tenderit.

Ne piken 4.1, te FDT-se ofrimin e varianteve eshtë autorizuar/lejuar, përkatësisht nuk eshtë ndaluar.

Ndërsa tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional AK-KEK, ka kërkuar, Katalog pjese te katalogut apo prezantime grafike dhe ose fotografi te produkteve me përshkrime teknike si dhe certifikate te produkteve ne lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet.

Pretendimi ankimor 2,

Bazuar ne kërkesat kualifikuese, OE "ProGlogal", shpk, ka ofertuar ne pajtueshmëri me te gjitha kërkesat e kualifikimit, ka prezantuar produkte ne pajtueshmëri dhe sipas standardeve, duke prezantuar dëshmi katalogë dhe certifikatat e konformitetit për produktet e ofruara, prandaj arsyetimi i eliminimit te ofertës sonë, bie ndesh me nenin 52, paragrafi 3 dhe nenin 59, te LPP-se.

Dorezat PVC7335 pjese e ofertes janë ofruar nga materiali PVC (Polyvinyl Chloride) rrjedhimisht eshtë ekuivalent/i ngjashëm me nitril material. Pjesa e brendshme eshtë gjithashtu nga materiali (cotton) pambuk. Dorezat e ofruara me oferte, ofrojnë siguri dhe me te larte se sa qe eshtë kerku ne FDT dhe DT, dhe një gjë e tille eshtë e lejueshme me LPP.

Dorezat PVC7335 pjese e ofertes jane me te avansuara si ne përdorim ashtu dhe ne

aspektin e sigurisë - janë te certifikuar

Neni 70, i LPP-se, "Standardet e sigurimit te cilësisë", përcakton:

"...Autoriteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së. Autoriteti kontraktues po ashtu pranon të dhënat e tjera të besueshme për

6/9

masat e barasvlershme të sigurimit të cilësisë nga operatorët ekonomik që nuk kanë qasje ose mundësi për sigurimin e certifikatave të tilla brenda afateve të caktuara".

Produktet tona kryesisht janë produkte "CE" dhe te dedikuara për tregun evropian, prandaj ju si AK do duhej ti trajtonit si te besueshme këto produkte dhe te barasvlershme me specifikacionet teknike te detyrueshme.

Ne DT eshtë kerku gjatësia e dorezës 30cm±2%

Dorezat PVC7335 pjese e ofertes janë me gjatësi 35cm – dallimi eshtë i papërfillshëm, ndërsa qe eshtë ne dobi te AK, meqe siguria eshtë me e larte për shfrytëzuesin/punëtorin, marre parasysh se dorezat janë për mbrojtje nga materiet kimike.

Prova 1 - Certifikata e konformitetit per dorezat PVC7335

Arsyetimi i AK, për doreza pune nga lëkura, se mungon gjatësia e dorezave, Madhësia e dorezës 10 eshtë 25.4cm, Niveli i mbrojtjes eshtë (4.1.3.3.X), NUK QENDRON

Ne DT pozicioni 2 eshtë kerku madhësia e dorezës 10, te jete me gjatësi 26cm ±1%

Niveli i mbrojtjes nga rreziqet mekanike (4.1.3.1)

Pretendimi ankimor 3,

Dorezat e lekures L-4 pjese e ofertesjanë me gjatësi 25.4cm – dallimi eshtë i papërfillshëm.

Niveli i mbrojtjes te dorezave pjese e ofertës eshtë (4.1.3.3.X)

Dorezat pjese e ofertës janë me kualitet me te larte, për arsyet:

Ne DT eshtë kërkuar rezistenca ndaj shpimit 1)

Dorezat pjese e ofertës kane rezistenca ndaj shpimit 3)

Nivel te sigurisë shtese kane dhe Rezistenca e prerjes ISO 13997 (A deri në F)

Arsyetimi i AK, doreza pune dimri, se mungon gjatësia e dorezës, NUK QENDRON

Ne DT pozicioni 3 eshtë kerku gjatësia 26cm ±1%,

Pretendimi ankimor 4,

Dorezat 330 pjese e ofertes dhe te kontestuara nga AK, janë me gjatësi 26cm

Arsyetimi i AK, helmete mbrojtëse industriale, se Mungon afati i qëndrueshmërisë, mungon pesha e helmetës, NUK QENDRON

Ne DT pozicioni 5 eshtë kerku - afati i qëndrueshmërisë te jete 5 vite

- Pesha e helmetës te jete e përafërt 350g ±4 %, ku te gjitha këto te dhëna janë te përshkruara dhe konfirmuara.

Helmeta QUARTZUP3 pjese e ofertes Eshtë me afat te qëndrueshmërisë 5 vite

Pesha e helmetës eshtë 345gr

8/9

Arsyetimi i AK për maske mbrojtëse nga gazrat me filtër, NUK QENDRON

Ne DT pozicioni 10 eshtë kerku - Maske mbrojtëse te klasës 1

- Filtrat 757-N

SQARIM

Maska mbajtëse Class 1 – eshtë maska me nivelin me te ulet te mbrojtjes.

Zakonisht përdoret për kohe te shkurte perdorimi dhe kur s'ka rreziqe te larta.

Filtri 757-N eshtë shenja e prodhuesit Climax, nuk përcakton kualitetin parametri 757-N

Filtri 757-N ka parametra shume me te ulte te mbrojtjes nga gazrat e ndryshëm, ne krahasim me filtrin BLS 400 SERIES pjese e ofertës.

Pretendimi ankimor 5,

Maska BLS 5000 SERIES pjese e ofertes Eshtë e klasës 3 – kjo dmth se ofron siguri për 3 here me shume se sa qe eshtë kerku ne DT (sa me i madhe parametri i klasës, për aqe

siguria eshtë me e larte). Maska BLS 5000 ofron nivelin me te larte te sigurisë.

Filtri BLS 400 SERIES pjese e ofertës plotëson dhe tejkalon kushtet e përcaktuara ne specifikimet teknike te DT ne krahasim me filtrin 757-N qe eshtë kërkuar

Filtri BLS 400 SERIES ka nivel te mbrojtjes me te larte – ABEK2

- Amoniaku dhe derivatet
- Acidet dhe avujt e gazrave
- Gazrat dhe avujt inorganik
- Gazrat dhe avujt organik
- Pluhurat

Ndërsa filtri ne DT, 757-N ka nivel te mbrojtjes me te ulte ABEK1

Prova 3 - Maska dhe Filtri

Aresyetimi i AK, per doreza gome/neopren, se ka ofruar trashësinë 0.75mm ndërsa eshtë kërkuar 1.1mm, NUK QENDRON

Ne DT pozicioni 13 eshte kerku dorezat te jene me trashësi 1.1mm

Me standardet:

EN420: 2003

EN388: 2003 (3,1,2,1)

EN374-1, EN 374-2, EN 374-3

9/9

Pretendimi ankimor 6,

Dorezat VE509 TOUTRAVO pjese e ofertes janë me trashësi 0.75mm.

Trashësia apo dhe pesha e materialit nuk përcakton kualitetin e produktit.

Avancimi i teknologjise se materialeve ka bere qe te produktet te jene sa me te lehta.

Dorezat VE509 TOUTRAVO ne oferte, ofrojnë siguri dhe me te larte se sa qe eshtë kerku ne FDT dhe DT, qe eshtë e lejueshme me LPP.

VE509, plotesojne standardet:

EN ISO 21420:2020 ;

EN388:2016+A1:2018 ;

EN ISO 374-1:2016+A1:2018 ;

EN16523-1: 2015 ;

EN ISO 374-2:2019 ;

EN ISO 374-4: 2019 ;

EN ISO 374-5:2016.

Dallimi ne trashesi eshte i paperfillshem, ndersa qe eshte ne dobi te AK, meqe siguria eshte me e

larte per shfrytezuesin/puntorin meqe jane te certifikuara me me shume EN Standarde, se sa eshte

kerkuar ne DT, marre parasysh se dorzat jane per mbrojtje nga materiet kimike.

Prova 4 – Dorezat VE509 TOUTRAVO

Aresyetimi i AK, per rrip sigurie, se Mungon standardi EN358, NUK QENDRON

Ne DT pozicioni 17 eshte kerku rripi i sigurise te jete sipas standardeve:

EN361 dhe EN358

Pretendimi ankimor 7

Rripi i sigurise HAR35 pjese e ofertes tani si produkt i ri prodhohet me emertim REVOLIN HAR35M

https://www.deltaplus.eu/en_US/article-details/-/article-details/warehousing/harnais-ceinture5pts-har35m/p/HAR35M_/ST71/0/0/8576640

10/9

Qe ploteson dhe tejkalon kushtet dhe standardet e kerkuara ne DT, meqe jane te certifikuara me

me shume EN Standarde, si: EN365; EN358; EN361; EN363; EN364

Jane gjithsejt 2 rripa te sigurise dhe furnizimin do te bejme me produktin e ri REVOLIN HAR35M

PROVA 5 – Rripi i sigurise REVOLIN HAR35M

Arsyetimi i AK, për doreza për saldues, se Eshtë ofruar gjatësi 35cm, madhësi 10, ndërsa eshtë

kërkuar gjatësi 32cm ±2% dhe madhësi 11, NUK QENDRON

Ne DT pozicioni 20 eshtë kerku doreza për saldues me gjatësia 32cm ±2%, madhësi 11.

Pretendimi ankimor 8

Dorezat për saldues CA615K pjese e ofertës janë me gjatësi 35cm.

Marre parasysh se janë me te gjata dhe se do te përdoren për saldim, dmth siguria eshtë me e madhe. Ndërsa dallimi ne gjatësi eshtë i papërfillshëm.

Dorezat prodhohen me madhësi 9, 10, 11.

AK -KEK, me rastin e porosisë mund te përcaktohet dhe zgjedhe madhësinë e dëshiruar

PROVA 6 – Doreza saldimi CA615K

11/9

Arsyetimi i AK, për syzet mbrojtëse për saldues, se Mungon trashësia e xhamit, NUK QENDRON

Ne DT pozicioni 21 eshtë kerku syze mbrojtëse për saldues me trashësi 2.6mm.

Pretendimi ankimor 9

Syzet mbrojtëse për saldues TOBA3 pjese e ofertes

Janë te standardizuara me standardet: EN 166 1 F ; EN 169; EN175 F, ashtu sikurse eshtë kerku dhe

ne Aneksi 1 – Specifikimet teknike te detyrueshme te DT trashesia e xhamit eshte 2.6mm

Standardet e përcaktojnë dhe kualitetin e syzeve mbrojtëse për saldues, përfshi dhe trashësinë e

xhamave.

PROVA 7 – Syzet TOBA3

Pra kompania jone ka prezantuar dëshmi siç eshtë kërkuar ne dosje te tenderit tek kërkesat e

kapacitetit teknik dhe profesional, rrjedhimisht ne piken 21.3, te FDT-se, eshtë përcaktuar qe:

"Mostrat e produkteve do te kërkohen te dorëzohen para nënshkrimit te kontratës vetëm nga OE

fitues".

Arsyetimet e AK ne Letrën standarde nuk qëndrojnë, madje bien ndesh me dispozitat e nenit 28

dhe 52, te LPP-se, ku paragrafi 3 përcakton: "Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht

janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim".

Pra AK, me rastin e eliminimit te ofertës sonë ka dale jashtë kërkesave te përcaktuara ne Dosje te

Tenderit dhe Njoftimit për kontrate. Vet fakti qe AK, ka kërkuar mostra te produkteve pas nënshkrimit

te kontratës nënkupton qe AK, gëzon te drejtën e aplikimit te dimensioneve cilësisë dhe te tjerave

përgjatë realizimit te kontratës e gjë ndërlidhet me nenin 81, te LPP-se – Menaxhimi i kontrates,

rrjedhimisht nuk mund te eliminohemi për qeshtje te cilat nuk janë përcaktuar si kërkesa kualifikuese

por kërkesa ekzekutuese.

Përmes sqarimeve shtese AK – KEK, ka mundur qe te qartësoj te gjitha produktet tona për te cilat

janë shfaqur dilemat dhe sic përcaktohet me nenin 59 dhe 72, te LPP-se.

Prandaj kërkojmë qe për trajtim te kësaj lende fillimisht OSHP, te autorizoi ekspert te fushës dhe

njohes te produkteve dhe natyrës se aktivitetit te prokurimit, rrjedhimisht Paneli shqyrtues te

nxjerr ketë:

V E N D I M

TE APROVOHET, ne tërësi ankesa jone si e bazuar

TE ANULOHET, njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit dhe

TE RIVLERESOHEN, ofertat dhe te kualifikohet si e përgjegjshme oferta jone, bazuar ne kërkesat

kualifikuese dhe dëshmitë e prezantuara dhe te sqaruara.

KRITERET PËR VLERËSIM

Furnizim me aksesorë për PPM			
Nr.	Përshkrimi i materialit	Njësia	Sasia
1.	**Dorëza gome mbrojtëse nga kimikatet** **Karakteristikat:** - Materiali- nitril - Pjesa e brendshme nga pambuku - Rezistuese nga kimikatet, - Rezistues nga dëmtimet mekanike, - Gjatësia e përafërt 30cm/ ±2%, - Madhësia 10, - Në pjesën e dorëzës të jenë të shtypura të dhënat teknike **Kushtet** - Standardi EN374-2; EN 420; EN388; Paketimi të jetë me ambalazh të prodhuesit	palë	54
2	**Dorëza mbrojtëse pune nga lëkura** **Karakteristikat;** - Përbërja e materiali të jetë nga lëkura e lopës. - Rezistues nga dëmtimet mekanike, - Cilësia e kualitetit : Klasa II, - Gjatësia 26cm ±1%, - Madhësia: 10, - Në pjesën e dorëzës të jenë të shtypura të dhënat teknike. **Kushtet** Standardi EN388:2016; Niveli i mbrojtjes nga rreziqet mekanike (4.1.3.1).	palë	30098

	Paketimi të jetë me ambalazh të prodhuesit		
3	**Dorëza pune dimri** **Karakteristikat:** - Përbërja e materiali të jetë nga lëkura e lopës. - Të jenë të rehatshme dhe të ngrohta, - Rezistues nga dëmtimet mekanike, - Cilësia e kualitetit : Klasa II, - Gjatësia 26cm ±1%, - Madhësia: 10, - Në pjesën e dorëzës të jenë të shtypura të dhënat teknike. **Kushtet** Standardi EN388:2016; EN 511 Niveli i mbrojtjes nga rreziqet mekanike (4,1,3,3), Niveli i mbrojtjes kundër temperaturave të ulëta (1.2.1), Paketimi të jetë me ambalazh të prodhuesit.	palë	4700
4	**Antifonë mbrojtës të veshit nga zhurma** **Karakteristikat:** - Të jenë rezistues për mbrojtjen e shqisave të dëgjimit nga zhurmat e larta në rast të tejkalimit të vlerave të dB, - Të kenë adaptuesin për kokë ABS, **Kushtet** - Standardi EN 352-1: 2020,	copë	110

	- SNR 32dB - Paketimi të jetë me ambalazh të prodhuesit		
5	**Helmetë mbrojtëse industriale** **Karakteristikat:** Materiali të jetë PE HD (polietileni me presion të lartë) Të ketë mbrojtje nga kontakti me përçuesit elektrik 440V a.c, Qëndrueshmëri nga temperaturat -30 °C deri +150 °C. Aksesorët për përshtatje në kokë të jenë me rregullator (rrotë), Të ketë rripin e sigurisë për mjekër, Rrjeta e brendshme të jetë nga materiali PE,LD dhe me 6 pika përforcimi, Pesha e helmetës të jetë e përafërt350g ±4%, Afati i qëndrueshmërisë të jetë 5 vite, Në pjesën e brendshme të helmetës të jenë të shtypura të dhënat teknike të prodhuesit, data e prodhimit dhe standardi. **Kushtet** - Standardi EN 397:2012+A1:2012, **Porosi** **Për TC Kosova A** - Helmeta ngjyrë të Kaltër – 14 copë, - Helmeta ngjyrë të Verdhë – 80 copë - Helmeta ngjyrë të Gjelbër – 6 copë **Te tjerat sipas porosisë nga Projekt Menaxheri** - Të vendoset **logoja e KEK me ngjyrë** sipas përmasave origjinale, - Paketimi të jetë me ambalazh të prodhuesit.	copë	2649
6	**Kapelë tekstili nën helmetë** **Karakteristikat:**	copë	1600

	Materiali nga pambuku, Të ketë një hapje në pjesën e fytyrës Gjatësia 45cm Ngjyra të jetë e kaltër Kapela-maska, të jetë e thjeshtë, të jetë e mjaftueshme për të mbuluar të gjithë kokën edhe qafën nga kushtet e erës dhe të ftohtit. **Kushtet** Paketimi të jetë me ambalazh të prodhuesit, Të ketë piktogramin.		
7	**Maskë mbrojtëse kundër pluhurit** **Karakteristikat:** - Niveli i mbrojtjes: FFP2 NR, - Faktori nominal i mbrojtjes: FNM 12, - Në pjesën e maskës të jetë e shtypur të dhënat teknike. **Kushtet** Standardi EN 149:2001+A1:2009, Paketimi të jetë me ambalazh të prodhuesit.	copë	35300
8	**Kapelë mbrojtëse dimri** **Karakteristikat:** - Materiali: Akryl 100%, - Mbrojtje nga të ftohtit: kat 1 - Ngjyra: Kaltër e mbyllte, - Madhësia: Universale **Kushtet** Paketimi të jetë me ambalazh të prodhuesit Të ketë piktogramin.	copë	2400

9	**Mbrojtëse gjuri** **Karakteristikat:** - Mbrojtës gjuri prej gome, i mbushur me gel ose shkumë, - Vendoset mbi pantallona dhe shtrëngohet me rripa neopren. **Kushtet** Standardi EN 14404 TIPI 1, Niveli 1 Paketimi të jetë me ambalazh të prodhuesit	palë	20
10	**Maskë mbrojtëse nga gazrat me filtër** **Karakteristikat:** - Materiali – gomë siliconi, - Xhami nga polikarbonati - Filtrat të jenë të fiksuar në maskë me një sistem bajonetë. - Shiriti i kokës dhe brezi i qafës të kenë mundësi rregullimi, - Filtrat 757-N - Faktori nominal i mbrojtjes FNM: 50 **Kushtet** Standardi EN 136 - Klasa 1; EN 148-1. Paketimi të jetë me ambalazh të prodhuesit	copë	20
11.	**Doreza pune akrilike** Standardet: EN388:2003 (3,2,3,1), Standardet CE Përcaktojnë: Rezistenca nga dëmtimet mekanike (gërvishtja, prerjes, fërkimeve, shpimit)	pale	10
12.	**Përparëse për saldues,** **materiali lëkur lope, dimensione 90 x 60cm,trashësia minimumi 1.0mm..**	copë	1

	Ne përputhje me Standardet			
	EN ISO 11611:2015 Tipi A1, Klasa 2	Standard për mbrojtje nga saldimet		
	Standardi CE			
	Doreza gome /neopren			
	Standardet	Gjatësia: 30 cm, trashësia 1.1 mm Në përputhje me direktivën evropiane 89/686 përbërje gome/neopren ,pjesa e brendshme e me pëlhurë pambuku.		
	EN420: 2003	Standard i përgjithshëm për doreza	pale	
13.	EN388: 2003 (3,1,2,1)	Rezistence prej shpimit,prerjes,gërvishtjes dh		300
	EN374-1,EN 374-2,EN 374-3	Mbrojtje nga kimikatet		
	(raportet e testimit) Standardi CE			
	Syza mbrojtëse: **Syzat janë të hapura anash (ajrim i hapur) me bartje komfore dhe në dukje të ngjashme me syzat e rëndomta.**			
14.	EN166 : 2001 - 1BT-3.4.9.	Standard për syza pune	cope	1500
	Standardet CE			

15.	**Kapelë me krahaqafë (haub)** Kapelë e thjeshtë me krahaqafë për mbrojtje nga pluhuri**.**	cope	650
16.	**Litar poliamid**e: me konektor, trashësi 14 mm ø, gjatësi **10m** EN353-2 — Standard për mbrojtje nga rënia nga lartësia Standardi CE	cope	2
17.	**Rrip sigurie:** Për gjithë trupin i lidhur mes shpinës dhe gjoksit, i bere nga 45mm shirit poliesteri, ne pjesën e kofshës behet hapja dhe rregullimi sipas pozicionit te trupit, ne përputhje me standarde EN361 — Standard për mbrojtje nga rënia nga lartësit EN358 — Standard për rrip sigurie mbrojtje nga rënia e Standardi CE	cope	2
18.	**Litar për ngritje:** me konektor L=20m/11mm EN 353-2:2002 — Standard për mbrojtje nga rënia e lartësive Standardi CE	cope	2
19.	**Kufje për mbrojtje të dëgjimit për një përdorim** EN352-2 — Standard për mbrojtje nga zhurma Standardi CE	copë	49
20.	**Dorëza për saldues** **Karakteristikat:**	palë	66

	- Përbërja e materiali nga lëkura e lopës, - Qepja të jetë me fije Kevlar, - Rezistues nga nxehtësia dhe flakët, - Rezistues nga dëmtimet mekanike, - Rezistues nga shpimi, prerjes dhe lagështisë. - Gjatësia 32cm ±2%, - Madhësia: 11, - Në pjesën e dorëzës të jenë të shtypura të dhënat teknike. **Kushtet** Standardi EN388:2016 përformancë mekanike; EN407: 2016 përformancë termike EN12477: Tipi A Paketimi të jetë me ambalazh të prodhuesit.		
21.	**Syze mbrojtëse për saldues** **Karakteristikat:** - Syze saldimi në formë rrethore, - Lentet të jenë nga polikarbonati me ngjyrë të errët - Diametri i përafërt i lenteve 50 mm, m trashësi 2.6 mm - Niveli i mbrojtjes DIN 5 ose 6. - Të jenë optimale për saldim me gaz, prerje, saldim elektrik, **Kushtet** Standardi: EN 166 1 F ; EN 169; EN175 F Paketimi të jetë me ambalazh të prodhuesit.	copë	35

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(VENDIMI MBI RISHQYRTIM)

ANALIZA DHE SQARIMI I KOMISIONIT TE VLERESIMIT

Pretendimet tuaja janë te pa bazuara pasi qe:

Autoriteti Kontraktues KEK sh.a. ka bere vlerësimin duke u bazuar ne kërkesat e dosjes se ten legjislacionit ne fuqi te aplikuar ne Republikën e Kosovës.

Oferta juaj nuk i ka plotësuar specifikat teknike te shume pozicioneve sipas aneksit 1 te dosjes se

Disa nga pikat te cilat e kane bere ofertën tuaj te papërgjegjshme janë dorezat neopren për te cilat kërkuar trashësia te jete 1.1 mm ndërsa ju keni ofruar 0.75 mm qe do te thotë ka një devijim te tra rreth 30% nga kërkesa e dosjes se tenderit, gjithashtu rendësi tjetër kane edhe pikat tjera si materi standardet, niveli mbrojtës te cilat për disa pozicione nuk janë ofruar sipas kërkesës se dosjes se t qe ka te beje me sigurinë e punonjësve te Korporatës.

REKOMANDIMI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni i vlerësimit rekomandon zyrtarin përgjegjës te prokurimit që kërkesa për rishqyrt PROGLOBAL SH.P.K, për tenderin "Furnizim me pajisje personale mbrojtëse në punë (akseso prokurimit KEK-23-2997-1-1-1, të refuzohet si e pabazuar.

KONKLUZIONI I ZYRTARIT PËRGJEGJËS TË PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në kërkesën për rishqyrtim e OE PROGLOBAL SH.P.K, i pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje mbrojtëse në punë (aksesor)" me nr. prokurimit KEK-23-2997-1-1-1, refuzon si te pabazuar ankesë për rishqyrtim te OE.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **PROGLOBAL SH.P.K.**

Pretendimi nr.1

Pretendimi I parë ankimorë sipas ankesës 610/23 është se AK nuk ka respektuar dispozitat e nenit 108/A të LPP-së.

Knkretisht OE ankues pretendon se të njëit kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim me 07.08.2023 ndërsa AK nuk është përgjigjur deri me 15.08.2023.

Pas analizimit të provave përmes E-Prokurimi eksperti shqyrtues konfirmon se kërkesa për rishqyrtim është bërë me 07.08.2023, ndërsa vendimi I AK-së është bërë me 15.08.2023 , do thotë jashtë afateve ligjore të parapara me nenin 108/A.

Sipas nenit 97 të rregullores 001/2022 për prokurim public, pika "p", Mosrespektimi i afateve kohore në nxjerrjen e vendimit në kërkesa për rishqyrtim konsiderohet Shkelje e Rëndë.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është I bazuar.

Pretendimi nr.2

Pretendimi tjetër ankimorë është se AK nuk I ka trajtuar pretendimet ankimore sipas kërkesës për rishqyrtim.

Pas analizimit të vendimit të AK-së kemi gjegtur se AK në mënyrë konkrete janë përgjigjur vetëm për trashësinë e dorezave neoprene, ku nga AK është kërkuar trashësia 1.1mm ndërsa OE ka ofruar 0.75mm.

AK për gjitha pretendimet tjera ankimore janë përgjigjur në mënyrë të përgjithësuar se për disa pozicione nuk janë ofruar sipas kërkesës së dosjes që ka të bëjë me sigurinë e punonjësve.

Edhe në këtë rast vlerësojmë se AK nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 108/A par.8 nënpar.8.4, andaj konsiderojmë se pretendimi ankimorë është I bazuar.

Pretendimi nr.3

OE ankues në ankesën e tij ka shumë pretendime rreth përmbushjes/mos përmbushjes së specifikave teknike të caktuara nga AK.

Për shumicën e pretendimeve ankimore sa I përket specifikave teknike konsiderojmë se OE i ka ofruar në pajtim me kërkesat e dosjses së tenderit ose kanë ofruar produkt ekuivalent në kuptim të nenit 28 par.6 të LPP-së. Pavarësisht dallimit në emërtim AK për shumicën e këtyre specifikave ka mund të kërkoj sqarime shtesë.

Megjithatë në këtë raport do të ndalemi në 3 pozicione/elemente të cilat konsiderojmë se nuk janë në përputhje me kërkesat e dosjes dhe nuk mund të konsiderohen se janë ekuivalente me atë që është kërkuar nga AK në dosje të tenderit.

Për pozicionin 1 është kërkaur doreza nga materiali "Nitril", ndërsa OE ankues ka ofruar doreza nga materiali PVC.

OE pretendon se kjo është vetëm variant I asaj qka është kërkuar dhe se variante nuk janë ndaluar me dosje të ternderit.

Pas analizimit të pretendimeve ankimore dhe pas hulumtimeve të bëra, kemi gjetur se materiali Nitril përveq se është më I shtrenjtë, në të njëjtën kohë është material më I qëndrueshëm se materiali PVC, andaj konsiderojmë se në rastin konkret nuk mund të thuhet se dorezat nga materiali PVC janë ekuivalente me dorezat nga materiali Nitril, pasi dorezat nga materiali Nitril janë edhe më shtrenjta edhe më të qëndrushme.

Pika e dytë është specifkacioni për doreza për saldues, ku kërkesë e dosjes ka qenë doreza për saldues me gjatësia 32cm ±2%, madhësi 11.

Ndërsa OE ankues në ankesë konfrimin se për këtë pozicion kanë ofrua doreza me gjatësi 35cm, megjithatë OE ankues pretendon se "*Marre parasysh se janë me te gjata dhe se do te përdoren për saldim, dmth siguria eshtë me e madhe. Ndërsa dallimi ne gjatësi eshtë i papërfillshëm*".

Eksperti shqyrtues vlerëson se në rastin konkret tejkalohet toleranca +-2% nga 32cm. Megjithëse OE ankues pretendon se dallimi është I papërfillshëm dhe me këtë ofrohet siguri edhe më e madhe, në rastin konkret vlerësojmë se është në diskrecion të AK-së të vlerësoj se nëse mospërputhja e dimensioneve të kërkuara është e pranueshme pwr AK-nw.

Sa I përket dorezave gome/neoprene, AK në specifikacion Teknik ka kërkaur trashësi prej 1.1mm, ndërsa OE ankues ka ofruar trashësi 0.75mm dhe pretendon se : "*Trashësia apo dhe pesha e materialit nuk përcakton kualitetin e produktit. Avancimi i teknologjise se materialeve ka bere qe te produktet te jene sa me te lehta".*

Edhe në këtë rast vlerësojmë se dallimi I dimensioneve/trashësisë së dorezës nga materiali I njëjt, nuk mund të kete ekuivalent. Thënë ndryshe trashesia 0.75mm nuk mund të jet ekuivalent me 1.1mm.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, me përjashtim të dorezave nga materiali Nitril (është ofruar PVC), dorezat për saldues (tejkalohet toleranca lejuar prej +-2), si dhe trashësia për doreza neoprene ku është kërkuar 1.1mm (është ofruar 0.75mm).

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet pjeserisht e bazuar, ndërsa vedimi i AK të mbetet në fuqi.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **PROGLOBAL SH.P.K.**

Ilir Halili

REPUBLIKA E KOSOVËS
PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA